



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve

Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Gusht 2024

I. Përmbajtja	
II. Hyrje	3
III. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve.....	4
A. Tregu i sigurimeve.....	4
1. Informacion mbi primet e shkruara bruto.....	4
2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit	6
3. Informacion mbi Investimet financiare të shoqërive të sigurimit.....	11
B. Tregu i Kapitaleve.....	13
1. Tregu me pakicë.....	13
2. Bursa Shqiptare e Titujve	14
3. Obligacionet me ofertë private dhe publike.....	15
A. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	17
IV. Përfundime	18

II. Hyrje

Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndërmarrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qenë se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht të Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (më tej, Autoriteti) monitoron me kujdes përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë e sigurimit, informacion për tregun e kapitaleve, fondet e investimeve dhe të pensioneve private. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive. Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe kartoni jeshil. Produkti i Kartonit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i lindin shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Për disa prej fondeve të investimit, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e aseteve të tyre në tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra investohet në valutë.

III. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet e shkruara bruto

Referuar të dhënave për 30.06.2024, primet e shkruara bruto për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë rezultojnë në rreth 11.88 miliardë lekë. Rreth 33.2% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Në mënyrë të detajuar, vihet re se përveç produkteve të detyrueshme të Kartonit Jeshil dhe Sigurimi Kufitar, ka edhe disa produkte vullnetare që rezultojnë me të ardhura pothuajse 100% të realizuara në Euro, siç është Sigurimi i kombinuar i Aksidenteve personale dhe shëndetit, Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Sigurimi i Jetës së Studentit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në Euro janë: Sigurimi Kasko, Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Ndërtim (CAR)¹, Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Montim (EAR)² dhe Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit në aktivitetin e sigurimit Jo-Jetë dhe Sigurimi i jetës dhe shëndetit në udhëtim, Sigurimi i Jetës së studentit, Sigurimi i Jetës me Kursim, dhe “Flexi Plan”³ për Sigurimin e Jetës. Ndërkohë, produktet si Sigurimi i Mallit në Transport apo Sigurimet e pronës paraqesin një nivel të lartë Euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve.

Referuar grafikut 1, në 30.06.2024 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë ka pësuar rritje me rreth 2.2% krahasuar me fundvitin 2023, duke shkuar në 33.6% nga 31.3%. Edhe pse brenda strukturës së klasave të sigurimit ka patur disa ndryshime, nuk ka patur efekt në peshën totale të primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit JoJetë.


Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2024, klasat që kanë shfaqur rritjen më të theksuar të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2023, janë: Sigurimi i Përgjegjësisë Civile me rritje me 4.9% (nga 44.1% në 49%), Sigurimet e Garancisë me rritje të peshës me 4.6% (nga 24.1% në 28.7%), Sigurimet e Pronës me rritje të peshës me 2% (nga 53.5% në 55.5%), pasuar nga Sigurimet Motorike me rritje të peshës me 0.9% (nga 24.2% në 25.1%). Ndërsa, rënie në peshë të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2023 janë: Sigurimet e Aksidenteve e Shëndetit me rënie të peshës me 4.5% (nga 62.7% në 58.2%), Sigurimet e Mallit në transport me rënie të peshës me 2.9% (nga 62.9% në 60%), Sigurimet e Marinës me rënie të peshës me 2.7% (nga 6% në 3.3%) dhe Sigurimet Inxhinierike me rënie të peshës me 2.6% (nga 82.2% në 79.6%).

¹ Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

² Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e montimit të makinerive dhe pajisjeve në objektet industriale.

³ Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon humbjen e jetës si pasojë e aksidentit, humbjen e jetës nga faktorë natyrorë, paaftësinë e përhershme të plotë, paaftësinë e përhershme të pjesshme, etj.


Grafik 1: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë në EUR kundrejt totalit



Referuar grafikut të mëposhtëm, në 30.06.2024, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt primeve të shkruara bruto në total për aktivitetin e Jetës ka shënuar një rënie të lehtë me rreth 0.3%, duke arritur në 28.9%, nga 29.2% që ka qenë në 31.12.2023.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2024, klasat që kanë shfaqur rritjen më të theksuar të primeve të shkruar në Euro në krahasim me 31.12.2023, janë: Sigurimi i kombinuar i Jetës, me rritje të peshës me 35% (nga 16.1% në 51.1%), Sigurimi Jeta e studentit me 34.4% (nga 28% në 62.4%), Sigurimi i Jetës në Grup me rritje të peshës me 29.4% (nga 3.5% në 32.9%) pasuar nga Sigurimi i Jetës me elementë kursimi me rritje të peshës me 2.5% (nga 92.9% në 95.4%). Ndërkohë paraqitet me rënie të peshës të primeve të shkruara në Euro Sigurimi Cash Plan me rënie të peshës me 25.8% (nga 62.2% në 36.4%), Sigurimi i Jetës me elementë të ndryshueshëm, me 13% (nga 71.7% në 58.7%), pasuar nga Sigurimi i Jetës së Debitorit me rënie të peshës me 1.8% (nga 21.4% në 19.6%).

Grafik 2: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës në EUR kundrejt totalit



2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit


Depozitat e shoqërive të sigurimit për periudhën 30.06.2024, të investuara në monedhat Lekë dhe valutë të huaj, rezultojnë në vlerë totale rreth 17.1 miliardë Lekë. Nga këto depozita, në monedhën vendase Lekë janë investuar rreth 10.3 miliardë Lekë, ose rreth 60% e totalit të depozitave, ndërsa ato në valutë rezultojnë të jenë rreth 6.8 miliardë Lekë, ose rreth 40% e vlerës totale të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 87.6% të depozitave totale në valutë dhe 35.1% të depozitave totale (lekë+valutë), pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2023, depozitat në valutë kanë pësuar rënie nga 38% më 31.12.2023 në 35% më 30.06.2024 ndaj totalit të depozitave të shoqërive të sigurimit. Kjo rënie vjen si pasojë e zhvlerësimit të monedhës Euro, duke arritur në nivelin më të ulët historik prej 100.31 më 30.06.2024.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024
Tregu Total	9,125	10,268	792	850	6,145	6,016

Grafik 3: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 4: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



a) Tregu i sigurimeve Jo-Jetë

Përsa i përket tregut të sigurimit Jo-Jetë, për periudhën 30.06.2024, janë investuar 8.5 miliardë Lekë në depozita në Lekë, ose rreth 58.9% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 5.9 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 41.1% kundrejt totalit të depozitave.


Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 52 milionë Euro, ose kundra vlerën rreth 5.2 miliardë Lekë. Depozitat e investuara në Euro zënë rreth 87.5% të depozitave totale në valutë dhe 36% të depozitave totale, pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2023, depozitat në valutë kanë shënuar rënie krahasuar me periudhën paraardhëse në vlerën rreth 0.7 milion lekë.

Rënia ka ardhur si efekt i zhvlerësimit të monedhës Euro kundrejt Lekut, por edhe si pasojë e shtimit të depozitave në Lekë dhe USD. Pesha e depozitave në Euro ndaj totalit të depozitave është ulur me 3.8%, krahasuar me 31.12.2023.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024
Tregu Jo-Jetë	7,403	8,533	686	745	5,337	5,218

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve Jo-Jetë



Grafik 6: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të Jetës


Përsa i përket tregut të sigurimit të Jetës, rreth 1.73 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose 66% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 903 milion Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose 34% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 7.9 milionë Euro, ose kundra vlerën rreth 0.8 miliardë Lekë. Depozitat në Euro zënë rreth 88.4% të depozitave në valutë dhe 30.3% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Raporti i depozitave në valutë me depozitat totale, nuk ka pësuar ndryshim në krahasim me fundin e vitit 2023.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024	31.12.2023	30.06.2024
Tregu Jetë	1,721	1,735	106	105	808	798

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve të jetës



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




3. Informacion mbi Investimet financiare të shoqërive të sigurimit

Investimet financiare të shoqërive të sigurimit për periudhën 30.06.2024, konsistojnë kryesisht në:


- Bono Thesari në Lekë, në vlerën 103 milionë Lekë, nga të cilat 46 milionë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 57 milionë Lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime nuk kanë pësuar ndryshime gjatë tre-mujorit të dytë, krahasuar me fund vitin 2023.
- Obligacione në Lekë, në vlerën 4.5 miliardë Lekë, nga të cilat rreth 3.26 miliardë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 1.26 miliard Lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime janë rritur me 80.9 milionë Lekë gjatë tremujorit të dytë të 2024. Gjithashtu, shoqëritë e tregut të sigurimeve kanë investuar dhe në obligacione në Euro, në vlerën 16.2 milionë Euro duke reflektuar një rritje të lehtë krahasuar me fundvitin 2023, me rreth 240 mijë euro.
- Kuota në fonde investimesh në Lekë, në vlerën 147.8 milionë Lekë, nga të cilat 122 milionë Lekë janë investuar nga shoqëritë e jo-jetës dhe 25.7 milionë lekë nga shoqëritë e jetës. Këto investime kanë pasur një rritje me 0.5% krahasuar me fund vitin 2023. Gjithashtu, shoqëritë e tregut të sigurimeve kanë investuar dhe në kuota në fonde investimesh në Euro, në vlerën 0.38 milionë Euro duke reflektuar një rritje të lehtë krahasuar me fund vitin 2023.

Investimet financiare në valutë në 30.06.2024 janë të gjitha në monedhën Euro dhe përbëjnë rreth 25.9% të totalit të investimeve financiare. Gjatë tre-mujorit të dytë të vitit 2024 me gjithë rritjen e investimeve financiare në monedhën Euro krahasuar me fund vitin 2023, vlera e këtyre investimeve ka pësuar rënie me 0.7% si shkak i zhvlerësimit të monedhës Euro.

Grafik 9: Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të investimeve financiare



Grafik 10: Pësja e Investimet financiare në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të Investimet financiare




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lekë, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë ka edhe emetues privatë të titujve që kanë kryer emetime në valutë. Autoriteti monitoron këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.


1. Tregu me pakicë

Të dhënat e tregut me pakicë përfshijnë tregtimin e titujve të borxhit të qeverisë mes bankave të licencuara dhe investitorëve individualë apo personave juridikë, në lekë dhe monedhën Euro. Tregu me pakicë dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar për llogari të investitorëve. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 transaksionet në valutë ndaj totalit të transaksioneve në tituj të qeverisë të tregut me pakicë arritën në rreth 1.32%.

Grafik 11: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritare




Grafik 12: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritare në %



2. Bursa Shqiptare e Titujve

Në Bursën Shqiptare të Titujve (ALSE), gjatë vitit 2023 dhe gjashtëmuajt të parë vitit 2024 janë realizuar transaksione në tituj të Qeverisë Shqiptare dhe obligacione korporative të emetuara nga një institucion financiar jo bankë, të nominuar vetëm në lekë.

Grafik 13: Pesha e transaksioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të transaksioneve në Bursën Shqiptare të Titujve




3. Obligacionet me ofertë private dhe publike


Tregu i kapitaleve iu ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre. Duke filluar nga dhjetori 2011, emetimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qënë një burim financimi për banka, institucione financiare dhe shoqëri tregtare. Obligacionet janë emetuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Totali i shumës së pashlyer të obligacioneve të emetuara nëpërmjet ofertave private në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 është 21,724 milionë lekë, nga të cilat 60% janë në euro (ekuivalenti në lekë 13,054 milionë) dhe 3% në USD (ekuivalenti në lekë 643 milionë).

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi me vendimin nr. 72, datë 28.04.2023 prospektin e parë për emetimin me ofertë publike të obligacionit të një subjekti financiar jo-bankë në shumën 500,000,000 lekë. Këto obligacione janë pranuar për tregtim nga Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE.


Grafik 14: Obligacionet me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera



Grafik 15: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë private të emtuara dhe të pashlyera



Grafik 16: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë publike të emtuara dhe të pashlyera



A. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve


Në 30.06.2024, në tregun e fondeve të investimit kanë kryer aktivitet trembëdhjetë fonde të hapura me ofertë publike, shtatë nga të cilët kryejnë aktivitetin në valutë të huaj, kryesisht në Euro. Fondet e tjera të investimit kryejnë veprimtarinë në monedhën vendase Lekë.


Asetet neto të fondeve, të cilët kryejnë aktivitetin e tyre në valutë të huaj, janë rreth 46 mln Euro (4.631 miliardë lekë) dhe zënë rreth 9.58% të totalit të aseteve neto të tregut. Edhe detyrimet e fondeve që mbahen në valutë të huaj, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit, ndaj bankës depozitare dhe detyrime për pagesat ndaj kuotambajtësit, zënë rreth 13.74% të detyrimeve të tregut.

Asetet neto të fondeve të tjera të investimit, asetet dhe detyrimet e të cilave mbahen në monedhën vendase lekë, janë rreth 43.7 miliardë Lekë dhe zënë rreth 90.42% të totalit të aseteve neto të tregut.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2024, vlera e aseteve neto të fondeve në valutë ka pësuar rritje në krahasim me fundvitin 2023 me 4.37% për shkak të rritjes së veprimtarisë së këtyre fondeve dhe hyrjes në treg të një fondi të ri investimesh që kryen aktivitetin në monedhën Euro gjatë kësaj periudhe. Megjithatë pesha specifike që këto fonde zënë ndaj totalit të aseteve neto të tregut të fondeve të investimit ka pësuar një rënie të lehtë nga 9.76% në fundvit 2023 në 9.58% në 6-mujorin e parë të vitit 2024.

Grafik 17: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit





Sa i përket fondeve të pensioneve private, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë

IV. Përfundime

Pesha e vlerës së asetëve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro-s) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen *investitorëve*, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.